



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



United Nations
ALBANIA



Empowered lives.
Resilient nations.

AKSESUESHMËRIA



Leave
No One
Behind

@ UNDP


Tiranë, Korrik 2018

Autore: Sidita Fortuzi

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij udhëzuesi për qëllime përfitimi

Ky udhëzues u realizua përmes programit “Askush të mos mbetet pas”, financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim e Bashkëpunim, SDC, dhe zbatuar nga UNDP.

Mendimet e shprehura në këtë udhëzues u përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP.



Seksioni “Aksesueshmëria” përmbledh legjislacionin që rregullon aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë seksion gjendet informacion mbi:

Ligj nr. 108/2012 Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
Fletore Zyrtare Nr.157 6 Dhjetor 2012
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/157-2012.pdf

Ligj nr. 93/2014 Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara
Fletore Zyrtare Nr. 135 28 Gusht 2014
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/135-2014.pdf

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”
Fletore zyrtare Nr. 243, 11 Janar 2016
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/243.pdf

Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008 rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”
Fletore Zyrtare Nr. 178 11 Dhjetor 2008
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2008/PDF-2008/178-2008.pdf

Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
Fletore Zyrtare Nr. 137 1 Shtator
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf

Ligji Nr.8308, datë 18.3.1998 Për Transportet Rrugore
Fletore Zyrtare Nr. 8, miratuar 18.03.1998, botuar më 10.04.1998
<http://www.qbz.gov.al/Ligje.pdf/transport/Ligj%208308%20%20per%20transportet%20rrugore%20i%20perditesuar.pdf>

Ligj Nr. 22/2018 për Strehimin Social
Fletore Zyrtare Nr. 79, 30 Maj 2018
<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%2079/LIGJ%20nr.%2022-2018,%20date%203.5.2018.pdf>

VKM. Nr. 708 Datë 26.8.2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore”
Fletore Zyrtare Nr. 154, 2 Shtator 2015
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/154-2015.pdf

Plani Kombëtar i Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016-2020
Fletore Zyrtare Nr. 124, 72016
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf

Ligj nr. 8098, datë 28.3.1996 për „Statusin e të Verbërit“
Fletore Zyrtare Nr. 13, datë 28.03.1996 (botuar 09.04.1996)
<http://www.sherbimisocial.gov.al/ëp-content/uploads/2014/03/6.pdf>

Ligj nr.7889, datë 14.12.1994 Për Statusin e Invalidit
Fletore Zyrtare Nr. 19, datë 14.12.1996 (botuar 10.01.1995)
<http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/L-I-G-J-per-statusin-e-invalidit.pdf>

Ligj Nr. 8626, datë 22.6.2000 Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik
Fletore Zyrtare Nr. 20, datë 22.06.2000 (botuar 18.07.2000)
<http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/42.-ligji-8626-date-per-para-dhe-tetraplegjiket.pdf>

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara: Neni 9 Aksesi

Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë akses në ambjentet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat do të përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit do të zbatohen ndër të tjera:

- (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe facilitete të tjera në ambjente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambjentet e punës;
- (b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.

Gjithashtu, shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për:

- (a) Të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj objekteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun;
- (b) T'u siguruar që subjektet private të cilat ofrojnë objekte dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruar për publikun të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuar;
- (c) Të ofruar tranim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë më aksesin për personat me aftësi të kufizuar;
- (d) T'u siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në gjuhën Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme;
- (e) Të siguruar forma asistence direkte dhe të ndërmjetme, duke përfshirë guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar aksesin në ndërtesa dhe objekte të tjera publike;
- (f) Të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjejes për personat me aftësi të kufizuar për tu siguruar që ata të kenë akses në informacion;
- (g) Të nxitur aksesin e personave me aftësi të kufizuara ndaj informacioneve të reja dhe sistemeve të teknologjive të reja të komunikimit, duke përfshirë dhe internetin;
- (h) Të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.

Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara

Cili është qëllimi i këtij ligji?

Së pari, ligji mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Së dyti ai përcakton përgjegjësitë dhe rregullat për të gjitha institucionet publike, qendrore, vendore dhe ato private në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara.

Çfarë do të thotë përfshirje?

Përfshirja është pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.

Çfarë është aksesueshmëria?

“Aksesueshmëri” është heqja e pengesave të të gjitha llojeve. Në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të përfshihen në të gjitha sferat e jetës, duhet të hiqen pengesat të cilat ndalojnë përfshirjen e tyre dhe gëzimin e të drejtave si të gjithë të tjerët.

Por cilat janë këto pengesa?

Pengesat janë të llojeve të ndryshme. Ato ndahen në:

- Pengesat sociale, si për shembull qëndrimet, mentaliteti, paragjykimet, stereotipet e sjelljet tutelore;
- Pengesat mjedisore, si për shembull, vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar;
- Pengesat infrastrukturore, si për shembull në banesa, hapësira dhe shërbime publike;
- Pengesat institucionale, si për shembull ato në legjisllacion dhe politika.

Por si kërkon të realizojë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe heqjen e pengesave ky ligj?

- Ligji përcakton që të gjitha institucionet, publike apo private kanë detyrimin për të siguruar aksesueshmëri për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara aksesin në këto fusha: strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

- Për detyrat dhe përgjegjësitë e detajuara të këtyre institucioneve ligji kërkon miratimin e një vendimi, vendim ky i miratuar nga Këshilli i Ministrave Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.Më shumë informacion për vendimin gjendet më poshtë.
- Ligji ngre pika kontakti në të gjitha bashkitë me një ose disa persona përgjegjës të trajnuar për çështjet e personave me aftësi të kufizuara dhe të cilët kanë për detyrë të monitorojnë që politikat e programet hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- Ligji vendos mbi çdo ministri detyrimin për të caktuar një person që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar.
- Ligji garanton jetesë të pavarur duke i ndihmuar personat që të marrin vetë vendimet për jetën e tyre nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjet e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme. Për të kapërcyer pengesat që pamundësojnë jetesën e pavarur ligji parashikon disa shërbime: asistencë personale, pajisjet e mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesueshmërisë, përfshirë transportin, përshtatja e arsyeshme dhe, atëherë kur është e nevojshme, vendim-marrjen e mbështetur.
- Ligji siguron ngritjen e komisioneve të reja, të cilat përdorin mënyrat më të fundit të vlerësimit të personave, sipas nevojave dhe shkallës së rëndësës së aftësisë së kufizuar, për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Komisionet bëjnë vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, nevojave për shërbime, mjete dhe përkujdesje, me synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur në maksimum autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.
- Ligji përcakton që të gjitha institucionet kanë përgjegjësinë për të mbledhur statistika për personat me aftësi të kufizuara dhe mënyrat se si duhet t'i raportojnë këto të dhëna.
- Ligji siguron ndihmës personal të trajnuar, i cili mund të jetë në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretuesit të gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me aftësi të kufizuar në të folur. Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë formim për të mësuar se si t'i udhëzojnë ndihmësit personalë.
- Ligji parashikon sigurimin e mjeteve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për pajisje të tilla, për të kapërcyer pengesat, sipas vlerësimit të nevojës së bërë nga komisionet. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor siguron mjetet dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë koordinon me të*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).
- Ligji siguron përfshirjen e organizatave jofitimprurëse me të drejtë për t'u konsultuar dhe personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, për çështjet e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.
- Ligji ngre Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, i cili është organ që këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;

Kush monitoron zbatimin e këtij ligji?

Avokati i Popullit

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kush e financon këtë ligj?

Të gjitha shpenzimet që lidhen me sigurimin e aksesueshmërisë dhe shërbimeve që ngrihen nga ky ligj mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

Ligji parashikon gjithashtu që institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, marrin gradualisht masat për sigurimin e fondeve të nevojshme për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike. Kjo do të thotë që mënjanimi i pengesave nuk mund të ndodhë njëherësh, por do të realizohet gjatë një periudhe të caktuar kohore në mënyrë graduale.

Vendim “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”

Në zbatim të Ligjit për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

Çfarë rregullon ky vendim dhe cili është qëllimi i tij?

- Vendimi detajon përkufizimet dhe parimet e vendosura në Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë;
- Vendimi përcakton konkretisht masat që merren nga institucionet për heqjen e pengesave për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara;
- Vendimi gjithashtu shërben edhe për unifikimin e rregullave ekzistuese me ato të reja.

Ku zbatohet ky vendim?

Vendimi zbatohet në të gjitha bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara.

Vendimi zbatohet në të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët.

Vendimi zbatohet në të gjitha mjetet e transportit publik.

Vendime zbatohet në të gjitha mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

Cilat janë detyrimet e këtyre institucioneve?

Të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime për publikun, janë të detyruar që të miratojnë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi.

Por çfarë përmban ky plan?

Evidentohen objektet ekzistuese dhe shërbimet, për të cilat nevojitet përshtatshmëria;

Caktohen fondet e nevojshme për të realizuar përshtatshmërinë;

Përcaktohet afat kohor për realizimin e përshtatshmërisë.

*Këto institucione kanë detyrimin që, brenda 12 muajve nga data e miratimit të planit të masave të mësipërm, të fillojnë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë sipas planit;

* Një kopje e planit duhet t'i dërgohet Këshillit Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe bëhet publik në faqen e internetit e njëkohësisht i dërgohet edhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

*Institucionet kanë edhe detyrimin për të hartuar një raport vjetor në lidhje me realizimin e planit të masave për sigurimin e aksesueshmërisë.

Cilat janë pengesat e detajuara sipas vendimit?

*Sikurse u përmend më lart, ky vendim detajon përkufizimet e parashikuara në Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë. Vendimi parashikon dy lloje kryesore pengesash:

Pengesa në komunikim janë:

- a) vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim e dëgjim;
- b) vështirësitë në komunikim që kanë personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar.

Pengesa infrastrukturore janë:

- a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme;
- b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse;
- c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

Por si realizohet konkretisht heqja e pengesave?

Vendimi parashikon disa mënyra. Duhet të mbajmë në vëmendje që heqja e pengesave infrastrukturore, fizike apo arkitektonike parashikohen në Vendimin Nr.1503, datë 19.11.2008 për rregulloren "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar", i sqaruar më poshtë.

Këto mënyra të heqjes së pengesave janë:

- (i) duke siguruar proces komunikimi dhe informimi për individët me vështirësi shikimi ose plotësisht të verbër,
- (ii) duke botuar në gjuhën braille dhe/ose me shkrim të zmadhuar dhe/ose në formatin audio materiale të lidhura drejtpërdrejtë me interesat parësorë të këtij grupi njerëzish.

Për personat me aftësi të intelektit këto mënyra janë:

- iii) duke dhënë kohë të nevojshme për të procesuar, kuptuar dhe reaguar;
- iv) duke rimarrë dhe përsëritur informacionin, shpjeguar informacionin në gjuhë të thjeshtë, copëzuar informacionin në koncepte më të thjeshtuara, pa e tepruar, duke dhënë besimin dhe sigurinë gjatë komunikimit;

- v) përmes të dëgjuarit të vëmendshëm, mosndërprerja e panevojshme e ligjëratës, përdorimi i fjalive e i fjalëve të thjeshta në të shkruar;
- v) Përmes përkthimit në gjuhën shqipe të shenjave gjatë ofrimit të shërbimit publik pët këtë komunitet; Personi duhet të ketë përcaktuar paraprakisht takim në institucione.
- vi) Përmes përdorimit të figurave, fotove, ngjyrave në materiale të shtypura.
- vii) Institucionet e shërbimit të transportit publik dhe privat duhet të përmbushin detyrimin për të garantuar sistem transporti për individët e verbër ose me dëmtim të shikimit, duke përfshirë sistem të shpjegimit me audio për orientim në linjat e transportit.

Për transportin publik kërkohet të ofrojnë transport qytetas me mjete tërësisht të përshtatura minimumi çdo 1 (një) orë në çdo vendqëndrim dhe shërbim transporti ndërqytetas me mjete të përshtatura për personat me vështirësi në lëvizje, minimumi një herë në ditë.

Cilat institucione janë përgjegjëse për ofrimin e këtyre shërbimeve?

Të gjitha institucionet publike dhe jopublike, por vendimi përcakton institucionet e ligjit dhe tatim-taksave, institucionet e arsimit dhe botimit, të shëndetësisë, të punësimit e të transportit si të një rëndësie të veçantë.

Cili është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi?

Institucion përgjegjës për monitorimin për zbatimin e këtij vendimi është Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Ku mund të ankoheni për shkeljen e të drejtës për aksesueshmëri sipas këtij vendimi?

Ankesat për shkeljen e së drejtës për aksesueshmëri në shërbime publike mund të paraqiten nga çdokush apo çdo subjekt, si organizatë, kompani, biznes e të tjera para ministrit të MSHMS.

Por mund të drejtoheni edhe në gjykatë, tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi apo Avokati i Popullit, sipas kompetencave dhe tagreve ligjore që kanë këto institucione

Çfarë bën ministri në këtë rast?

Ministri përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar, nëpërmjet sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, merr në shqyrtim ankesën dhe u kërkon organeve kompetente referuese marrjen e masave administrative, si dhe përgatitjen e një informacioni për Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Çfarë bën Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kur konstaton shkelje?

Në rastet kur konstaton shkelje të këtij vendimi mund të marrë masa përkatëse sipas kompetencave të veta dhe duhet të njoftojë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Masat mund të jenë:

- Paralajmërim
- Gjobë
- Shkeljet ligjore me afate respektive për t'u korrigjuar.
- Masë urgjente "Pezullim" të pjesshëm apo të të gjithë subjektit të inspektuar

Çfarë bën në këtë rast MSHMS?

MSHMS nga ana tjetër për rastet e moszbatimit të rregullave u kërkon subjekteve përkatëse të marrin masat e nevojshme dhe të korrigojnë shkeljen brenda një afati, jo më shumë se ½ e afatit të parashikuar në planifikim.

- Plani duhet të miratohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi dhe 12 muaj nga data e miratimit të këtij plani duhet të fillojë realizimi progresiv i tij.
- Moszbatimi i rregullave të vendosura në këtë vendim përbën shkak për dhënien e masave disiplinore për punonjësit përgjegjës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Një nga aspektet më përforcuese të këtij vendimi është ndalesa e financimeve ose mbështetja financiare nga ana e shtetit apo enteve publike dhe jopublike/donorëve për ndërtimin e një vepre, me qëllim ofrimin e shërbimit publik, nëse objekti nuk përmbush kërkesat në vendim.

Cilat janë disa detyrime specifike për institucionet në nivel qendror?

Ndër institucionet në nivel qendror, vendimi ka vendosur detyrime specifike për dy ministri kryesore: Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe MSHMS. Konkretisht për MASR vendimi parashikon këto detyrime:

- MASR bën të detyrueshëm (pjesë të kurrikulës arsimore) mësimin e gjuhës Braille, krahas mëimit të gjuhës së shkruar dhe/ose të folur shqipe në shkollën speciale për personat që nuk shikojnë, e cila është pjesë e sistemit të arsimit të detyrueshëm.
- MASR siguron që 60% e stafit pedagogjik, përfshi organet drejtuese, të shkollës speciale për personat që nuk shikojnë janë persona që nuk shikojnë dhe që zotërojnë gjuhën braille.
- MASR përfshin në kurrikulat e arsimit të detyrueshëm për shkollën speciale për personat që nuk dëgjojnë mësimin e gjuhës së shenjave shqipe, krahas mëimit të gjuhës shqipe, të shkruar dhe/ose të folur.
- MASR merr masa që të paktën 10% e personelit pedagogjik të shkollës speciale për personat që nuk dëgjojnë janë persona që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin dhe që zotërojnë gjuhën e shkruar dhe gjuhën e shenjave shqipe.
- MASR ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë.

Ndërsa për MSHMS detyrimet kanë të bëjnë me:

- MSHMS zyrtarizon dhe publikon, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, kodin e gjuhës braille.
- MSHMS në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mëimit të gjuhës së shenjave shqipe
- MSHMS zyrtarizon dhe publikon, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Fjalorin e Gjuhës së Shenjave Shqipe.
- MSHMS në bashkëpunim me akademikë dhe ekspertizën e OJF-ve, përgatit, boton dhe shpërndan një udhëzues/manual për punonjësit e institucioneve të shërbimeve publike për mënyrat e komunikimit e të informimit të personave me aftësi të kufizuara mendore, si dhe për mënyrën e përpilimit të materialeve të shkruara për këta persona.
- Ndërkohë, detyrime të veçanta ka edhe për disa institucione të tjera qendrore ose të pavarura siç janë: KQZ, Ministria e Punëve të Brendshme, Media.

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:
- Në bashkëpunim me bashkitë, realizojnë në raste të caktuara, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, procese komunikimi konsultimi dhe këshillimi në distancë, me ndihmën e teknologjisë (telefon / televizion/internet) si dhe nëpërmjet videokonferencave.

Ministria e Brendshme:

- Pajis forcat e rendit me njohuri bazë për sinjalistikën me audio dhe forma të tjera të përshtatura për lëvizshmërinë e pavarur të njerëzve të verbër, njohjen e shkopyt të bardhë, gjuhës braille dhe shenjave të tjera dalluese, si mjete identifikuese të individëve të verbër.

Televizionet kombëtare dhe Media-t në përgjithësi:

- Televizionet kombëtare transmetojnë rregullisht emisionin kryesor të lajmeve në opsionin e transmetimit të shoqëruar me titra dhe me gjuhën e shenjave.
- Aplikojnë rregullat për aksesueshmëri nëpërmjet teknologjive të posaçme dhe ofrojnë për personat e verbër shpjegim në format audio të materialeve të transmetuara kryesisht me natyrë informuese, duke parashikuar në mënyrë progresive buxhetin përkatës për aplikim të përshtatshmërisë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara

Cili është qëllimi i kësaj rregulloreje?

Rregullorja ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.

Ku e shtrin Rregullorja aplikimin e saj?

Në të gjitha objektet e reja që ndërtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, qofshin ato objekte publike të ndërtuara me fonde të buxhetit të shtetit apo fonde private, qofshin ato objekte private. Në hapësirat publike dhe ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në hapësirat publike dhe objektet ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit.

Çfarë parashikon rregullorja në lidhje me objektet ekzistuese që nuk janë objekt ristrukturimi?

Rregullorja përcakton se në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe të llogariten të gjitha mundësitë për përshtatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.

Rregullorja përcakton gjithashtu se rregullat dhe standardet e përcaktuara në të aplikohen edhe në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun.

Cilat janë nivelet e cilësisë së hapësirave të ndërtuara në lidhje me personat me aftësi të kufizuara?

Mundësia e hyrjes shpreh nivelin më të lartë të shfrytëzimit total të hapësirave në mënyrë të drejtpërdrejtë. Mundësia e shfrytëzimit përfaqëson një nivel të mundësisë së kufizuar, të një hyrjeje, të ndërtesës ose të njësisë të patundshme, por që lejon mundësinë e krijimit të marrëdhënieve të domosdoshme edhe për personat me aftësi të kufizuara motorike ose ndijuese. Përshtatshmëria është një mundësi hyrjeje e diferencuar që përfaqëson një nivel bazë, me mundësi për t'u përmirësuar.

Ligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

Çfarë parashikon ky ligj për personat me aftësi të kufizuara?

- Parashikon që planifikimi e zhvillimi duhet të garantojnë eliminimin e barrierave, për një përdorim të sigurt, të barabartë e të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuara ose grupe të veçanta, për të cilët janë të nevojshme zgjidhje teknike apo pajisje të veçanta;
- Të gjitha ndërtime për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas dispozitave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.
- Përshtatshmëria e ndërtimeve të reja apo në proces rikonstruksioni është kusht për marrjen e lejes së ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit;
- Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun janë të detyruara të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.

Cilat janë autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit?

Në nivel qendror:

- a) Këshilli i Ministrave;
- b) Këshilli Kombëtar i Territorit;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në nivel qarku:

- a) këshilli i qarkut.

Në nivel bashkie:

- a) këshilli bashkiak;
- b) kryetari i bashkisë.

Ligji për Transportin Rrugor

Cili është qëllimi i këtij ligji?

Ky ligj zbatohet për të gjitha llojet e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

Çfarë parashikon ky ligj për personat me aftësi të kufizuara?

- Ligji vendos detyrimin që të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjes për ta.

- Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta. Ligje të veçanta këtu mund të konsiderohen Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik, Statusi i të Verbërit dhe Statusi i Invalidit të Punës. Por me ndryshimet e reja shume kategori të tjera do të përfitojnë, përveç atyre që i përkasin këtyre statuseve.
- Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Vendim i Këshillit të Ministrave “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore

Çfarë detyrimesh vendos ky vendim?

Institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe qarqet mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar, sipas fushave ku operojnë, me qëllim hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e politikave në mbështetje të programeve të aksesit dhe të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara dhe ia dërgojnë Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, përpunon të dhënat e grumbulluara, nëpërmjet sekretariatit teknik për aftësinë e kufizuar, të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Instituti i Statistikave bën anketime të dedikuara për çështjet e aftësisë së kufizuar. Rezultatet e anketimeve i bën publike dhe informon, zyrtarisht, ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Ligj për Strehimin Social

(hyn në fuqi 6 muaj pas miratimit. Është miratuar më 3.5.2018)

Çfarë rregullon ky ligj?

Ligji përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Çfarë konsiderohet strehim i përshtatshëm dhe i aksesueshëm?

- Strehimi konsiderohet i përshtatshëm për një individ dhe/ose familje atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.
- Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson: qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët, duke lehtësuar shkallën e plotësimin të nevojave të veçanta të banimit për ta dhe akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare.

Përveç detyrimit për strehim të përshtatshëm, si mbrohen personat me aftësi të kufizuara në këtë ligj?

Përmes parimit të mosdiskriminimit:

Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese.

Gjithashtu ligji siguron që askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura më sipër përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t'i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.

A kanë detyrim për t'u konsultuar me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara autoritetet shtetërore?

- Çdo subjekt që zbaton një program social strehimi përfshin në proces konsultimi komunitetin që preket dhe/ose atë që përfiton nga programi, në përputhje me ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".
- Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë informacion të plotë, të lehtë për t'u gjetur, të kuptueshëm dhe të lexueshëm për çdo individ/familje.

Cilat janë këto programe?

a) Programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ

Çfarë nënkupton ky program?

Programi i banesave sociale me qira është programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social;

Gjithashtu edhe subvencioni i qirasë është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.

Përparësi në subvencionimin e qirasë i jepet personave me aftësi të kufizuara;

b) Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri

Çfarë nënkupton ky program?

Nënkupton ndihmën që u jepet nga buxheti i shtetit njësive të vetëqeverisjes vendore, për të kthyer objektet që janë pronë shtetërore në banesa, me qëllim strehimin.

Kjo ndihmë jepet edhe për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private.

Çfarë nënkuptohet me përmirësim të kushteve?

Me përmirësim të kushteve të banesave ekzistuese dhe, nëse është e nevojshme, deri në ndërtim të ri, kuptohet të gjitha punimet që duhet të kryhen, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm.

*Përparësi në trajtimin me këtë program kanë personat me aftësi të kufizuar

c) Programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU: Banesë me kosto të ulët (BKU)

Çfarë nënkupton ky program?

Banesë me kosto të ulët është ajo që plotëson të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit dhe i jepet një përfituesi nëpërmjet formave të ndryshme të lehtësimit nga institucionet shtetërore.

Banesat me kosto të ulët që sigurohen nëpërmjet ndërtimit, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku vlerat e tregut janë me të larta se kostoja e ndërtimit, shiten me çmim nën vlerën e tregut, por jo nën vlerën e koston së ndërtimit.

Në rastet kur vlera e banesës në tregun e lirë është më e ulët se kostoja e ndërtimit, këto banesa blihen dhe përfshihen në programin e BKU-së, nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

ç) Programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi

Çfarë nënkupton ky program?

Njësitë e vetëqeverisjes vendore planifikojnë sipërfaqet e nevojshme të truallit për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin. në bazë vlerësimit të nevojave për strehim social dhe kërkesave për ndërtim banesash sociale.

Zhvillimi i zonës me qëllim strehimin bëhet për ndërtimin e banesave sociale, në bazë të dokumenteve të planifikimit qendror e vendor.

d) Programi për krijimin e banesave të përkohshme

Çfarë nënkupton ky program?

Strehat e përkohshme janë objekte ose pajisje që montohen dhe çmontohen lehtë dhe që shërbejnë për strehim të përkohshëm.

Me strehim të përkohshëm kuptohet strehimi për një afat deri në dy vjet.

Menjëherë me strehimin në strehët e përkohshme, përfituesit e këtij programi duhet të aplikojnë në programet e tjera sociale të strehimit.

Strehët e përkohshme shërbejnë për strehimin e refugjatëve, individëve që zhvendosen nga vendbanimi për shkak të fatkeqësive natyrore a njerëzore, individëve që zhvendosen për shkak të investimeve publike ose private dhe nuk përfitojnë kompensim, vetëm në ato raste kur njësia e vetëqeverisjes vendore dëshmon se nuk ka asnjë alternativë tjetër strehimi në kuadër të programeve të tjera të strehimit social, emigrantëve të rikthyer, personave të pastrehë, që banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim.

dh) Programi i banesave të specializuara

Çfarë nënkupton ky program?

Banesat e specializuara janë banesat në të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore adresojnë një nevojë specifike strehimi për grupime të veçanta si, të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara e të tjerë.

Banesat e specializuara sociale për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme, të përshtatur dhe të aksesueshme për lehtësimin e sigurimin e marrjes së ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të njoftimit, në raste emergjencash. Për banesat e kësaj kategorie parashikohen në katet e para mjedise të nevojshme për fizioterapi, shërbime mjekësore, shërbime sociale, si dhe mjedise të përbashkëta për jetë komunitare. *Banesat e specializuara për të moshuarit dhe/ose personat me aftësi të kufizuara jepen në uzufukt, me afat sa jetëgjatësia e përfituesve.

Uzefrukti është e drejta e një personi (uzefruktari) për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë.

Kur kjo kategori nuk ka të ardhura familjare/individuale, atëherë dhënia në uzefrukt bëhet pa shpërblim.

Duhet mbajtur në vëmendje që, një individ ose familje nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë.

Kush përfiton nga këto programe?

Çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:
 - i) i fatkeqësive natyrore;
 - ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;
 - iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;
 - iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

Duhet mbajtur në vëmendje që kriteret e mësipërme zbatohen vetëm për ato individë ose familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura.

Ku drejtohen personat me aftësi të kufizuara për të aplikuar?

- Aplikimi bëhet në zyrën e njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit ose vendqëndrimit të aplikantit.
- Individu/familja plotëson vetëm kërkesën për programin social të strehimit, që i jepet në njësinë e vetëqeverisjes vendore.
- Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë.

Cilat janë kriteret për të përfituar?

Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve apo familjeve përfituese bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:
 - i) nuk disponojnë banesë në pronësi;
 - ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;
 - iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;
 - iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;
 - vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.

- b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi:
- i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
 - ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
 - iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;
 - iv) bashkëshortët, moshë e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrijnë deri në 60 vjeç.

Cilat kategori trajtohen me përparësi?

Ndër të tjerë, trajtohen me përparësi personat me aftësi të kufizuara.

Plani Kombëtar i Veprimit për PAK, aksesueshmëria

Çfarë ka marrë përsipër Plani Kombëtar i Veprimit për PAK në lidhje me aksesueshmërinë?

Deri në vitin 2020 qeveria qendrore dhe vendore marrin përsipër të ofrojnë akses të barabartë në shërbime dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar aksesueshmërinë fizike të shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara.

Ministritë dhe institucionet në varësi të tyre do të kryejnë një vlerësim të nivelit të aksesueshmërisë. Ky vlerësim kryhet nga një ekip kontrolli me ekspertë të arkitekturës, inxhinierisë dhe të projektimit universal. Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë gjithashtu pjesë e ekipit.

Qeveria qendrore dhe vendore marrin përsipër të përmirësojnë aksesueshmërinë e qendrave të kujdesit rezidencial (p.sh. tualetet, fjetoret, kuzhina dhe mjediset e tjera të shërbimeve, mjediset e përbashkëta, etj).

Qeveria qendrore dhe vendore marrin përsipër përmirësimin e aksesit në informacion për personat me aftësi të kufizuara.

Faqet e internetit të institucioneve do të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara

Do të ketë pajisje audio/dixhitale dhe në gjuhën e shenjave nëpër muze.

Librat do të jenë në formate dixhitale dhe alfabetin Braille në Bibliotekën Kombëtare.

Do të ketë interpretë të gjuhës së shenjave në mënyrë që ata të futen në institucione publike. Qeveria vendore dhe qendrore garantojnë transportin publik për çdo individ me aftësi të kufizuara.

MSHMS organizon trajnime për inspektorët që do të monitorojnë zbatimin e standardeve të aksesueshmërisë nga subjektet publike në nivel qendror dhe vendor.

Ligj Për statusin e të Verbërit

Çfarë parashikon statusi për aksesueshmërinë e të verbërve?

- Shteti krijon kushte të përshtatshme për banim, të sipërfaqes së banimit dhe të pajisjeve të zakonshme dhe speciale;
- Këshillat e Rregullimit të Territorit dhe organet e urbanistikës nuk miratojnë asnjë projekt për rrugët e mjediset publike, në qoftë se në to nuk janë mbajtur parasysh përshtatjet

e nevojshme dhe të mundshme të tyre për të verbërit. Shteti kujdeset për strehimin e të verbërve, duke siguruar veçanërisht për të verbërit e grupit të parë, ose që barazohen me ta, një dhomë mbi kubaturën normale dhe përshtatjen e saj në raport me kushtet fizike.

- Enti Kombëtar i Banesave përballon shpenzimet për blerjen dhe përshtatjen e banesës që përfitojnë të verbërit.

Ligj Për statusin e Invalidit

Çfarë parashikon statusi për aksesueshmërinë e invalidëve?

- Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëllor si të tjerët, t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t'u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese.
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore administron pajisjen e invalidëve me: a) mjete lëvizëse dhe pajisje të ndryshme ortopedike; b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; c) me mjete ndihmëse kardiake etj
- Shteti cakton për invalidët sipërfaqe të caktuara në shtëpi pushimi bregdetare, malore, balneare, ku bëhen përshtatjet e duhura për mënjanimin e barrierave arkitektonike.
- Mjediset e institucioneve shëndetësore, të përkujdesjes shoqërore dhe ato publike përshtaten për përdorimin e tyre nga të verbrit dhe paraplegjikët, që janë invalid pune.
- Të gjitha ndërtime të reja publike që realizohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të ofrojnë mundësi përdorimi nga kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.

Ligji Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik

Çfarë parashikon statusi për aksesueshmërinë e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë?

- Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëllor si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.
- Shteti merr përsipër trajtimin me përparësi me strehim, nëpërmjet kredive të dhëna me kushte lehtësuese për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
- Ministria e Shëndetësisë merr masa që në spitalet e nivelit të dytë dhe të tretë të përshtaten dhe të pajisen një deri dy dhoma për shtrimin eventuale të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.
- Në vende publike (aerporte, stacione treni, stadione, hotele etj.) krijohen mjedise për lëvizjen, qëndrimin dhe shërbimin për paraplegjikët sipas ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit".

